



**Partia
Demokratike**

Nr. 380 prot.

Tiranë, më: 29.04.2025

K Ë R K E S Ë

KËRKUES: Partia Demokratike përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z.
Flamur Noka, me adresë komunikimi: Bulevardi " Zhan D' Ark " Nr. 11, Tiranë dhe adresë email: pd@rithemelimi.com

OBJEKTI: Kërkesë për marrjen e masave urgjente lidhur me votimin e zgjedhësve shqiptarë nga jashtë vendit.

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

**STRUKTURA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR - SPAK**

Zotërinj ,

Protokolli i dakordësuar ndërmjet partive politike, KQZ-së dhe operatorit të shërbimit postar DHL parashikonte që çdo zgjedhës nga Diaspora do të merrte njoftim nëpërmjet email/sms për mbërritjen e zarfit me materialet zgjedhore. Zgjedhësi zgjidhte mënyrën e tërheqjes së zarfit duke u paraqitur fizikisht në pikën më të afërt të DHL ose duke ardhur postieri për t'ia sjellë në shtëpi. Dorëzimi i zarfit i bëhej personalisht zgjedhësit pasi identifikohesh me mjetin e identifikimit dhe nënshkruante.

Nga informacionet e marra nga ana jonë rezulton se ky protokoll nuk është respektuar, pasi zarfet me materialet zgjedhore i janë dorëzuar një përfaqësuesi të familjes apo edhe personave të tjerë të paautorizuar, pa u identifikuar me mjet identifikimi zyrtar dhe pa nënshkruar zgjedhësi personalisht marrjen e zarfit. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me kthimin mbrapsht të zarfit me fletën e votimit. Në raste të tjera zarfi është lënë në hyrje të pallatit, apartamentit apo në kutinë postare, pa u marrë në dorëzim nga askush.

Këto problematika janë konstatuar kryesisht dhe masivisht në Greqi. Një nga rastet konkrete është ai i përfaqësuesve të Partisë Socialiste në Kretë, shtetasve Afrim Avdiaj, Tajar Osmanaj, Marg Gega dhe Arben Haveri, të cilët janë paraqitur në pikën e shërbimit postar Courier (i nënkontraktuar nga DHL) dhe kanë tërhequr të gjitha zarfet e zgjedhësve të zonës. E njëjta praktikë është përsëritur nga shtetasi Genci Hymetllari në zonën e Kavallës.

Thyerja e këtij protokolli ka krijuar kushtet dhe rrethanat për shkeljen e fshehtësisë së votimit dhe votimit më shumë se një herë të dyja këto vepra penale të parashikuara nga Kodi Penal shqiptar. Kjo veprimtari e paligjshme është tërësisht përgjegjësi e KQZ-së dhe operatorit postar DHL, të cilat në shkelje të detyrimeve të tyre nuk kanë marrë të gjitha masat për të garantuar fshehtësinë e votës dhe mosvotimin më shumë se një herë të çdo zgjedhësi.

Përveç këtyre problematikave, ky proces është shoqëruar edhe me probleme të tjera si mosmbërritja e zarfit me materialet zgjedhore, mospërgjigja e operatorëve postar DHL për marrjen mbrapsht të zarfeve, mosgjetja e fletës së votimit në zarfin "A", gjetja e dy fletëve të votimit në të njëjtin zarf "B", gjetja e fletëve të votimit të pavulosura. Të gjitha këto problematika janë adresuar nga përfaqësuesit ligjorë të PD-së pranë KQZ-së dhe DHL-së, por nuk kanë marrë përgjigje.

Kjo sjellje dhe mënyrë veprimi e KQZ-së dhe DHL-së ka vënë seriozisht në rrezik procesin zgjedhor të votuesve nga Diaspora, duke rrezikuar pavlefshmërinë e të gjithë procesit për shkak të parregullsive të konstatuara.

Prandaj, Partia Demokratike dhe Aleanca për Shqipërinë Madhështore kërkojnë një reagim të menjëhershëm nga KQZ dhe DHL për sqarimin e situatës, ndërkohë kërkojnë nga Struktura e Posaçme Antikorrupsion fillimin e një hetimi të menjëhershëm për të zbuluar veprimtaritë e paligjshme, identifikuar personat përgjegjës dhe procedimin e tyre penal. Çdo patronazhist po monitorohet nga ana jonë dhe i sigurojmë se çdo veprim i paligjshëm do të marrë ndëshkimin më të ashpër ligjor. Ne nuk do të lejojmë që vullneti i zgjedhësve shqiptarë nga Diaspora të manipulohet, vidhet apo tjetërsohet me mekanizmat kriminalë që regjimi i Edi Ramës ka vendosur në punë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Mbetemi në pritje të reagimit Tuaj,

K Ë R K U E S

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

PËRFAQËSUAR NGA

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Flamur NOKA

